

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

Kuvendi i Kosovës

Mbledhja plenare e Kuvendit

Mbledhja nr.2002/15

Prishtinë, më 3 tetor 2002, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala plenare

Procesverbali, tetor 2002-10-07

Mbledhjen e kryesoi Nexhat Daci, kryetar i Kuvendit

Nga ana e kryesuesit u propozua ky

R E N D D I T E

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Aktivitetet e Tregtisë me Jashtë (2002/6).
3. Themelimi i Komisionit për media,
4. Parashtrimi i pyetjeve.

Në fillim të mbledhjes, kryesuesi i shprehu mirëseardhje mikut të vjetër të Kosovës, z.Xhozef Diogardit dhe bashkëshortës së tij.

Kryesuesi i pyeti deputetët se a pajtohen me propozimin e rendit të ditës?

Hajrdin Kuqi tha se në rend dite duhet të përfshihet edhe çështja e grevës së arsimtarëve.

Sabri Hamiti tha se PSSP, z. Shtajner, ka shpallur një program për zgjidhjen e problemit të Mitrovicës, i cili përmban shtatë pika dhe se nuk dihet se a është konsultuar ai paraprakisht me kryesuesit e institucioneve të Kosovës. Z. Hamiti ishte i mendimit se duhet ftuar PSSP-në në mbledhjen plenare të Kuvendit dhe të jep sqarime plotësuese se si e mendon ai relizimin e ketij programi.

Kryesuesi ishte i mendimit që të mos debatohet sot për këtë çështje, por në njerën nga mbledhjet e ardhshme të ftohet PSSP z. Shtajner dhe të shtrohet kjo çështje.

Arsim Bajrami tha se mbështetë iniciativat e parafolsëve dhe duhet z. Shtajner të marrë pjesë në mbledhjen e ardhshme plenare dhe të jep sqarimne para deputetëve.

Rada Trajkoviq tha se pajtohet që të hapet debat lidhur me çështjen e Mitrovicës, por, njëkohësisht, tha ajo, duhet të shtrohet edhe çështja e qyteteve të tjera, veçanërisht ajo e kryeqytetit, dhe pyeti pse tanë në këto qytete nuk ka serb, apo është numër fare simbolik në krahasim me tri vjet më herët.

Nekibe Kelmendi shtroi problemin e dokumentacionit kadastral si dhe të lëndëve gjyqësore të Kosovës, të cilat gjenden në Serbi. Ajo tha se qytetarët e Kosovës, për të realizuar të drejtat e veta shpesh udhëtojnë për në Krushevc, ku atje detyrohen të paguajnë shuma të mëdha (deri në 3000€) për të marrë ndonjë dokument. Ajo kërkoi që z. Shtajner të angazhohet që ai dokumentacionin të kthehet në Kosovë.

Oliver Ivanoviq u ndërlidh me diskutimin e znj. Kelmendi dhe tha se kur ajo thotë se në Krushevc qytetarët e Kosovës paguajnë ryshfet nga 3000€, për të marrë ndonjë dokument, atëherë ajo lë të flas me emra konkretë, se kush janë ata.

Hydajet Hyseni kishte vërejtje të natyrës procedurale për diskutimet e znj. Kelmendi dhe të z. Ivanoviq. Ai tha se duhet t'i përbahemi Rregullorës së punës së Kuvendit, ku parashihet se rendin e ditës e përgatitë Kryesia e Kuvendit, por mund të debatohet në mbledhje plenare edhe per çështje të ngutshme.

Kryesuesi tha se për mbledhjen e ardhshme plenare duhet të ftohen PSSP, z. Shtajner, ku do të flas për çështjen që e ngritëm sot.

Mevlyde Saraçi, shtroi problemin e imunitetit të deputetëve. Ajo tha se, para ca ditësh, gjatë fushatës zgjedhore, është ndaluar nga policia e UNMIK-ut dhe për një orë ishte e arrestuar.

Kryesuesi tha se Kryesia e Kuvendit disa herë ka debatuar për këtë çështje. Deputetët e Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë nuk kanë trajtim dinjitoz. Ne, si Kuvend, tha kryesuesi, protestojmë ndaj asaj që u ka ndodhur juve (i referohej znj. Saraçi). Institucioni i Kuvendit, vazhdoi kryesuesi, ose do të respektohet sikur çdo parlament në botë, ose ne do t'i marrim masat tona.

Hajredin Kuqi, në emër të grupit parlamentar të PDK-së, shprehu habinë pse në mbledhjen plenare nuk marrin pjesë Kryeministri dhe ministri i Tregtisë dhe i Industrisë, të cilët, në këtë mbledhje do të duhej të arsyetonin propozimin e Qeverisë për Projektligjin mbi Aktivitetet e Tregtisë me Jashtë. Ai ishte i mendimit se duhet hifikur një rendi i ditës shqyrtimin e këtij Projektligji, pasi që nuk është ministri përkatës të flas për te.

Ali Jakupi tha se është i autorizuar nga ana e Qeverisë që të flas për qëllimet dhe arsyeshmërinë e Projektligjit që është në rend dite.

Kryesuesi tha se duhet respektuar mendimin e grupit parlamentar të PDK-së.

Buajar Dugolli tha se është bërë praktikë jo e mirë që kur shqyrtohen ligjet në Kuvend, apo diskutohet rreth problemeve të ministrive përkatëse, kjo ka n'dodhë edhe më herët kur është diskutuar në Kuvend rreth grevës së arsimtarëve, kjo po ndodhë edhe sot që ministrat përkatës nuk janë prezent në mbledhje. Prandaj, ai në emër të grupit parlamentar të AAK-së, tha se Qeveria dhe ministrat duhet të jenë më seriozë dhe më të përgjegjshëm ndaj Kuvendit.

Xhezair Murati ishte i mendimit se duhet përkrahur propozimin e grupit parlamentar të PDK-së, të mos shqyrtohet Projektligji i paraparë për sot, por mund të debatohet për çështjen e grevës së arsimtarëve.

Kryesuesi tha se duhet formuar Komisiomnin për media dhe kërroi nga deputetët që të deklarohen. Pas numrimit të votave, rezultati ishte:

Për.....	84 vota,
Kundër.....	asnjë
Abstenime.....	asnjë.

Kryesuesi kërroi nga grupet parlamentare që të i propozojnë përfaqësuesit e vetë në këtë komision, që të fillojë punën sa më parë. Kryesuesi tha se çështjen e grevës së arsimtarëve nuk mund ta shtrojmë pa praninë e përfaqësuesit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, por në emër të Kuvendit mund të nxjerrim këtë qëndrim: Eshtë fundi i fyres së dinjitetit të arsimtarëve, të cilët më së shumti e kanë bartur barrën e shoqërisë që nga vitet e '68-ta, '81-ta '90-ta. Qeveria duhet të obligohet që deri më 1 nëntor të gjejë zgjidhje përgritjen e pagave të arsimtarëve, kurse ata të ndërpresin grevën dhe që nesër të fillojnë punën.

Xhavit Haliti ishte i mendimit se Kuvendi duhet të nxjerrë një ligj, me të cilin do t'u ndalojë deputetëve të këtij Kuvendi që më shumë se 30% të orarit të punës mund të punojnë në ndonjë punë tjeter. Këtë ai e arsyatoi me qëllim të ngritisës së efikasitetit dhe cilësisë së punës në Kuvend.

Rada Trajkoviq tha se ne nuk mund të bisedojmë se sa t'ua ngrisim pagat arsimtarëve, por duhet të formohet një grup nga Qeveria dhe Ministria e Arsimit dhe të shihen mundësítë reale të rritjers së tyre.

Bujar Dugolli tha se arsimtarët nuk kanë nevojë përfjalë të mira dhe të embla, siç po ndëgjohen në këtë Kuvend, por ata kërkojnë përkrahje konkrete. Andaj, ai propozoi që Kuvendi Kosovës t'i mbështes kërkësat e arsimtarëve dhe Kuvendi duhet të autorizojë Ministrinë e Ekonomisë dhe të Financave, Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë që të hartojnë një plan konkret përritjen e pagave punëtorëve të arsimt.

Kryesuesi tha se për realizimin e këtij vendimii duhet të formohet një komision prej përfaqësuesve të komisioneve përbuxhet dhe të arsimt t'ë Kuvendit, së bashku me Ministrinë e Arsimit dhe Qeverinë, që ta finalizojnë këtë vendim. Pagat e arsimtarëve deri më 1 nëntor duhet të rriten.

Arsim Bajrami ishte i mendimit se Kuvendi, në parim, duhet t'i mbështhes kërkësat e arsimtarëve, kurse Qeveria do të obligohet që të gjejë zgjidhje.

Kryesuesi, duke u mbështetur edhe në diskutimet e deputetëve të tjera, tha se Kuvendi i Kosovës i mbështet kërkësat e arsimtarëve dhe kërkon nga Qeveria që deri më 1 nëntor 2002 të dalë me program konkret përritjen e pagave të arsimtarëve.

Kryesuesi dha në votim këtë propozim dhe rezultati i votimit ishte:

për.....74,
kundër.....asnjë, dhe
abstenime.....17.

Ali Sadriu , ministër i Ekonomisë dhe i Financave, tha se nuk qëndron vlerësimi se Qeveria e Kosovës nuk është përpjekur të gjejë zgjidhje për problemet e arsimit. Kemi kontaktuar me Bankën Botërore, Fondin Monetar Ndërkombëtar, USAID-in. etj. Qeveria është duke hulumtuar burime shtesë për zhgjidhjen e këtij problemi. Problem në vete paraqet fakti, vazhdoi ai, se në sistemin arsimor të Kosovës ka mbi 2.000 arsimtarë tepricë dhe kjo është barrë për buxhetin e Kosovës.

Ramush Haradinaj ishte i mendimit se Qeveria e Kosovës, në të ardhmen, duhet më shumë të konsultohet dhe të kërkojë ndihmën e Kuvendit të Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 11,25.

Kryetari i Kuvendit
Akademik Nexhat Daci

Sekretari i Kuvendit